

NJOFTIM PARAPRAK

për publikim të Thirrjes publike të dytë për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga komponenta e pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Unionit Europian (IPARD Programa 2007-2013)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural i lajmërojnë të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se në gjysmën e **dytë të muajit Shtatorë 2010** viti do të publikohet Thirrja publike e dytë për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga komponenta e pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Unionit Europian (IPARD Programa për periudhën 2007-2013 "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/2009 nga data 03.07.2009)

Qëllimi i IPARD Programit 2007-2013 është përmes masave përkatëse për përkrahje të bujqësisë dhe zhvillimit rural të përmirësohet konkurrenca e prodhimit bujqësor dhe sektori bujqësoro-ushqimor, përmes përputhshmërisë së tyre me standardet e Unionit Europian dhe arritja e mjedisit jetësor të qëndruar dhe zhvillimi socio-ekonomik të mjediseve rurale përmes rritjes së aktivitetit ekonomik dhe rritjen e mundësive për punësim.

Mjetet financiare nga IPARD Programa 2007-2013 në lidhje me zbatimin e Thirrjes publike të dytë nga Shtatori 2010 dedikohen për masat në vijim:

Masa 101 – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit të tyre për arritjen e standardeve të Unionit Europian.

Masa 103 – Investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Unionit Europian.

Masa 302 – Diverzifikim dhe zhvillim të aktiviteteve ekonomike rurale.

Mjetet e parapara financiare për zbatimin e Thirrjes publike të dytë janë gjithsej **40.028.365,00 EUR** prej të cilave 75% janë kontribute nga EU dhe 25% janë kontribute nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, të cilët do të llogariten në kundërvlerë të denarit me kurs që vlen për muajin Shtatorë 2010. Mjetet e planifikuara financiare janë kumulative dhe e përfshijnë periudhën financiare 2008-2010 viti.

Rregullat për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programa 2007-2013 udhëzojnë arritjen e kontratës paraprake të shfrytëzuesve potencial me Agjencionin për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe realizimin e investimit të lejuar në bazë të arritjes së kushteve të kontraktuara. Kontrollim në vend të ngjarjes dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kontratës e kryejnë personat e autorizuar nga Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë për udhëheqje, zbatim dhe kontrollë të IPARD dhe Unioni Europian.

Mënyra dhe procedura për shfrytëzimin e përkrahjes financiare nga IPARD Programa 2007-2013 janë të shënuara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga komponenta e pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Unionit Europian ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 112/2009 nga data 09.09.2009).

Shpallja do të zgjasë **60 ditë** nga dita e publikimit të Thirrjes publike në shtypin ditorë.

Informata më detale në lidhje llojet e investimeve që do të jenë të përkrahura, kriteret për fitimin e përkrahjes financiare, lartësia e përkrahjes sipas masave të interesuarit mund t'i marrin në:

Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

Telefoni: 02 3097-460

Faksi: 02 3097-454

e-mail adresa: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

www.ipardpa.gov.mk

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujrave

Trupi për udhëheqje me IPARD

Telefoni: 02 3109-809

Faksi: 02 3110-887

e-mail adresa: info@ipard.gov.mk

www.ipard.gov.mk

Agjencioni për nxitje të zhvillimit në bujqësi

Telefoni: 047 228-330

047 228-370

www.agencija.gov.mk

Çdo ditë pune prej ora 8:30 h deri 16:30 h.

Informata për përgatitjen dhe dorëzim të kërkesave, si dhe këshillat praktike për aplikim, të interesuarit prodhues bujqësorë mund t'i marrin në qendrat regjionale të Agjencionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi. (Lista e kontakteve të qendrave regjionale dhe personave kompetentë është e shpallur në web faqen e institucioneve kompetente).